



Kodi i Sjelljes së forumZFD

Hyrja dhe qëllimi

Duke respektuar misionin dhe vlerat e veta, Forumi i Shërbimit Civil Paqësor (forumZFD) është i përkushtuar të ruajë shkallën më të lartë të sjelljes etike të të gjithë stafit të vet. Kodi i Sjelljes (KS) mbështetet mbi vlerat dhe parimet tona të përbashkëta që shpalosen në Nenet e Shoqatës dhe Deklaratën e Misionit të organizatës.

Objektivi i Kodit të Sjelljes është të krijojë të kuptuar të përbashkët për parimet dhe rregullat e sjelljes së stafit të forumZFD-së, duke promovuar kështu standarde të njëjta dhe të vazhdueshme të sjelljes. Ai parashtron parimet dhe rregullat për sjelljen tonë etike, shoqërore dhe ligjore. Kodi është hartuar për të ofruar udhëzim dhe mbrojtje për të gjithë personat e punësuar nga dhe që punojnë me forumZFD-në, duke paraqitur se çka konsiderohet sjellje e pranueshme profesionale dhe etike.

Kodi është hartuar për të funksionuar si udhëzues, por nuk mbulon çdo situatë të mundshme me të cilën mund të përballet stafi. Çdo situatë në të cilën pjesëtarët e stafit do të kenë dyshime për çështje që mbulohen nga Kodi duhet të diskutohen në mënyrë konfidenciale brenda linjave të tyre raportuese, si për shembull menaxherin e linjës, personat kontaktues të Aktit për Trajtimin e Përgjithshëm të Barabartë (AGG)¹, këshillin e punës ose Përfaqësuesin e Interesit (PI).

Fushëveprimi

Ky Kod i Sjelljes zbatohet për të gjithë stafin e kontraktuar, pavarësisht llojit të kontratës së tyre, fushëveprimit të përgjegjësive të tyre dhe vendndodhjes së vendit të punës. Kodi është i zbatueshëm për stafin vendor dhe ndërkombëtar, punonjësit me kohë të plotë ose të pjesshme, personelin e përkohshëm, punonjësit e angazhuar, si dhe vullnetarët, praktikantët, konsulentët dhe profesionistët e lirë, të punësuar nga dhe që punojnë për Forumin e Shërbimit Civil Paqësor.

¹ Akti për Trajtimin e Përgjithshëm të Barabartë (AGG) është ligj gjerman që ka për synim të parandalojë dhe eliminojë diskriminimin mbi baza të origjinës racore apo etnike, gjinisë, fesë apo besimit, aftësisë së kufizuar, moshës apo identitetit seksual. Për ta arritur këtë qëllim, personat e mbrojtur nga ligji kanë të drejtë të paraqesin kërkesa ligjore kundër punëdhënësve apo individëve privatë nëse ata shkelin ndalesat statutoare për diskriminim ndaj tyre.

Për qëllime të këtij dokumenti, personat e specifikuar më lart do të përmenden më tutje në tekst si “stafi”.

Anëtarët e organeve të Shoqatës (Bordi Mbikëqyrës dhe Bordi Ekzekutiv) së forumZFD-së, si dhe menaxhmenti i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar të forumZFD-së (GmbH) dhe Bordi Ekzekutiv i fondacionit të forumZFD-së duhet ta respektojnë Kodin e Sjelljes.

Kodi i Sjelljes zbatohet në të gjithë botën.

Ndërsa e pranojmë se ligjet vendore dhe kulturat dallojnë dukshëm, forumZFD është Organizatë Joqeveritare Ndërkombëtare, prandaj Kodi i Sjelljes është hartuar në bazë të standardeve ndërkombëtare. Stafi i forumZFD-së janë të detyruar të respektojnë ligjet vendore kudo që ata veprojnë. Aty ku ligjet vendore përcaktojnë detyrime më të rrepta nga ato që përmenden në Kodin e Sjelljes, ligjet vendore kanë përparësi.

Kodi është i zbatueshëm gjatë kohës që stafi janë në detyrë dhe ai do të respektohet jashtë vendit të punës dhe jashtë orarit të punës nëse mund të krijohet lidhje ndërmjet stafit dhe punës së forumZFD-së.

Në raste individuale, Kodi i Sjelljes mund të plotësohet nga shtesa të nevojshme për shkak të kontekstit lokal. Këto shtesa duhet të listohen si shtojca dhe t’i dorëzohen Bordit Ekzekutiv para se të miratohen.

Zbatimi

Kodi i Sjelljes është pjesë përbërëse e të gjitha kontratave të punësimit apo kushteve për shërbime në bazë të pagesave. Kodi i Sjelljes u shpërndahet dhe u shpjegohet të gjithë stafit para se ata të fillojnë punën.

I gjithë stafi duhet të konfirmojë me shkrim se e kanë lexuar dhe e kanë kuptuar Kodin e Sjelljes, se ata respektojnë të gjitha rregullat e sjelljes dhe se e pranojnë që respektimi i këtij Kodi të Sjelljes është kusht për punësimin apo angazhimin e tyre.

Burimet Njerëzore janë përgjegjëse për t’u siguruar se Kodi i Sjelljes zbatohet, monitorohet dhe vlerësohet rregullisht. Është në dorë të nivelit të menaxhmentit të forumZFD-së që të përcaktojë standardin duke u sjellë vetë me integritet. Në zyrën qendrore, menaxherët duhet të sigurohen që stafi i tyre e ka kuptuar dhe nënshkruar KS-në, në programe kjo detyrë i takon drejtorëve vendorë apo rajonalë.

Kodi i Sjelljes është dokument publik. Të gjithë partnerët e forumZFD-së duhet të informohen për Kodin e Sjelljes tonë kur pajtohen me Memorandum të Mirëkuptimit (MM).

Kodi i Sjelljes

Parimet e sjelljes për Forumin e Shërbimit Civil për Paqe (forumZFD)

1. Të përkushtuar ndaj paqes dhe jodhunës

Unë do të sigurohem se sjellja ime është në përputhje me vlerat e forumZFD-së. Do t'i respektoj të drejtat e njeriut dhe dinjitetin njerëzor dhe do të veproj sipas kushtit bazë të jodhunës.

Përmes veprimeve dhe sjelljeve të mia, unë do të mbështes parimet e barazisë gjinore, gjithëpërfshirjes, drejtësisë sociale dhe solidaritetit. Jam i vetëdijshëm se dhuna dhe lufta nuk janë në përputhje me këto vlera dhe kështu, nuk do të përfshihem në asnjë aktivitet apo sjellje që përdor këto mjete.

Do të bëj përpjekjet e mia më të mira për ta mbrojtur mjedisin dhe do të punoj në mënyrë të qëndrueshme.

Promovimi i transformimit konstruktiv jo të dhunshëm të konflikteve

Si punonjës i forumZFD-së, jam i përkushtuar ndaj praktikës së transformimit konstruktiv jo të dhunshëm të konflikteve. Do të përmbahem nga çdo formë e dhunës ndaj qenieve njerëzore dhe natyrës, si dhe do të jem i vetëdijshëm për format subtile të dhunës në marrëdhëniet shoqërore, në përdorimin e gjuhës dhe sjelljes. Konsideroj se konfliktet janë jo vetëm rrezik për trazira, por edhe pjesë e procesit të nxënies dhe mundësi për ndryshim pozitiv. Në përputhje me qëllimet dhe parimet e forumZFD-së, unë do të bëj përpjekje që t'i trajtoj konfliktet e brendshme në mënyrë konstruktive.

Puna me partnerë

Strukturat e qëndrueshme për paqe duhet të zhvillohen dhe të mbështeten nga vetë akterët në zonat e konfliktit. Prandaj, do të punoj bashkërisht me partnerët dhe akterët lokalë në mënyrë të barabartë dhe të drejtë, mbështetur në besimin e ndërsjellë.

2. Si i trajtoj njerëzit

Parimi i mosdiskriminimit

Si punonjës i forumZFD-së, jam i përkushtuar ndaj mbështetjes së vlerave të diversitetit dhe mosdiskriminimit në të gjitha detyrat e mia të punës. Unë do të respektoj të drejtat e barabarta të të gjithëve me fokus special tek grupet e cënueshme dhe të ndjeshëm ndaj traumave. Do të kontribuoj për një mjedis pune profesional që karakterizohet nga respekti i ndërsjellë, integriteti,

dinjiteti, diversiteti dhe mosdiskriminimi. Do të përmbahem nga mbështetja e të gjitha formave të mundshme të strukturave të pushtetit diskriminues.

Do të sigurohem që marrëdhëniet e mia dhe sjellja ime nuk janë shfrytëzuese apo abuzuese në asnjë mënyrë.

Do të respektoj të drejtat e të gjithë njerëzve, përfshirë të drejtat e fëmijëve.

Do të punoj me njerëzit në mënyrë të ndjeshme dhe jodiskriminuese në aspektin e etnisë, origjinës shoqërore, ngjyrës së lëkurës, kombësisë, fesë apo botëkuptimit, kodit të veshjes, aktivitetit nëpër sindikata, kulturës, arsimit, statusit martesor, nevojave të veçanta, moshës, orientimit seksual, identitetit gjinor apo çdo karakteristike tjetër dalluese.

Do të largohem nga të gjithë dhe çdo lloj i diskriminimit si dhe ngacmimit apo bullizmit apo drejtimit me gjuhë të papërshtatshme, të dhunshme apo fyese ndaj të tjerëve.

Respekti për kulturën dhe zakonet

Unë kam pikësynim të kuptoj dhe do të respektoj normat kulturore në ato vende ku punon forumZFD dhe të kolegëve dhe të komuniteteve me të cilët punoj, për sa kohë që ato nuk shkelin të drejtat e njeriut apo nuk çojnë drejt diskriminimit të disa grupeve të popullsisë.

3. Anti-ngacmimi dhe anti-racizmi

forumZFD nuk toleron asnjë formë të ngacmimit.

Ngacmimi i referohet çdo sjelljeje të padëshiruar që ndodh me qëllim apo efekt të shkeljes së dinjitetit të një personi dhe që krijon mjedis frikësues, armiqësor, degradues, poshtëruës apo fyese.

forumZFD e konsideron ngacmimin e ndërlidhur me etnicitetin, origjinën shoqërore, ngjyrën e lëkurës, kombësinë, fenë apo botëkuptimin, kodin e veshjes, aktivitetin në sindikata, kulturën, arsimin, statusin martesor, nevojat e veçanta, moshën, orientimin seksual, identitetin gjinor apo karakteristika të tjera dalluese si formë të diskriminimit.

Unë nuk do të kryej asnjë akt apo formë ngacmimi dhe nuk do të përfshihem në asnjë sjellje, të qëllimshme ose jo, që e bën shënjestrën të ndjehet i persekutuar, i cënueshëm ose pa fuqi.

Nuk do të angazhohem në asnjë formë të ngacmimit seksual, abuzimit seksual apo shfrytëzimit seksual dhe nuk do ta toleroj atë nga kolegët nëse shoh që po ndodh kjo formë e sjelljes.

Ngacmim seksual përkufizohet çdo sjellje e natyrës seksuale që cënon dinjitetin e personit, që konsiderohet e padëshirueshme, e paparanueshme, e papërshtatshme ose fyese ndaj dhe nga

shënjestra, ose që krijon mjedis pune frikësues, armiqësor, të paqëndrueshëm dhe fyes. Ajo mund të jetë fizike, verbale dhe joverbale. Mund të përfshijë, por jo vetëm, kontakt fizik të padëshirueshëm apo tentativa të padëshirueshme apo kërkesa të natyrës seksuale.

4. Integriteti dhe reputacioni i forumZFD-së

Mbrojtja e integritetit dhe reputacionit të organizatës

Unë mbështes integritetin dhe reputacionin e forumZFD-së duke u siguruar që sjellja ime nuk dëmton vlerat dhe parimet e veprimtarisë së forumZFD-së që parashtrihen në deklaratën e misionit.

Marrëdhëniet me publikun dhe median

Unë do të respektoj kodin e marrëdhënieve me publikun dhe udhëzuesit për media sociale të forumZFD-së në kuadër të punës me media dhe komunikimin e jashtëm në emër të forumZFD-së. Unë do të kem parasysh politikat e “mos shkakto dëm” dhe “ndjeshmërisë ndaj konfliktit” në të gjitha komunikimet.

Para së gjithash, nuk do të shpërndaj asnjë përmbajtje apo komente që mund të vënë në rrezik reputacionin dhe ndjekësit e punës së forumZFD-së apo që mund t'i shkaktojë dëm stafit, organizatave partnere ose komuniteteve, në çfarëdo mënyre.

Gjithnjë do t'i trajtoj me kujdes informatat dhe deklaratat për partnerët, kolegët, organet financuese dhe donatorë. Çështjet e brendshme i nënshtrohen konfidencialitetit dhe nuk duhen bërë publike.

Jam në dijeni dhe marr parasysh se, sidomos në situata konflikti, deklaratat private dhe postimet në media sociale mund të ndërlidhen me organizatën.

5. Trajtimi i konfliktit të interesit

Mund të paraqiten konflikte ndërmjet interesave të mia personale dhe interesave të forumZFD-së dhe atyre të partnerëve tanë apo të grupeve të targetuara lidhur me punën time. Unë do të tregoj transparencë sa i përket konflikteve potenciale të interesit dhe menjëherë do t'i bëj ato të ditura dhe do t'i diskutoj me menaxherin tim direkt. Unë do t'i zgjidh ato në mënyrë të verifikueshme dhe të kuptueshme për të gjitha palët e përfshira.

Do të tregoj vëmendje ndaj gjendjeve ku interesat personale qartazi janë në kundërshtim me interesat e forumZFD-së. Në rast dyshimi, do ta diskutoj këtë me menaxherin tim përkatës.

Do të tregoj ndjeshmëri të lartë ndaj pozicionit tim brenda strukturave të pushtetit dhe nuk do ta abuzoj në asnjë mënyrë në kontekst të punës time brenda forumZFD-së në tërësi si dhe lidhur me partnerët dhe në kontekst të punës time.

6. Konfidencialiteti / Përdorimi i të dhënave dhe njohurive / Shfrytëzimi i burimeve

Unë do të shfaq diskrecion gjatë trajtimit të informacionit të ndjeshëm ose konfidencial gjatë dhe gjithashtu pas punësimit tim me forumZFD. Do ta bëj të sigurtë qasjen në të gjithë informacionin dhe sistemet e kontabilitetit të forumZFD-së dhe do t'i mbroj të dhënat që janë relevante për punën e forumZFD-së.

Informacioni i ndjeshëm mund të përfshijë, por jo vetëm, të dhëna personale, informacion për partnerët, informacion që shprehimisht është shenjuar si konfidencial, të dhëna financiare, kontrata dhe dokumenta strategjikë. Kur të kem dyshime sa i përket asaj se çfarë përbën informacion sensitiv, do të konsultohem me menaxherin tim të linjës para se ta ndaj.

Do të mbledh, përdor dhe procesoj informacionin, sidomos të dhënat e personelit, në mënyrë konfidenciale dhe vetëm ashtu si e lejon ligji dhe si kërkohet për punën e forumZFD-së.

Do të mbaj përgjegjesi sipas rregullit për të gjitha paratë dhe pronat e forumZFD-së (p.sh. automjetet, pajisje zyre, akomodimi që ofrohet nga forumZFD, kompjuterat, përfshirë edhe përdorimin e internetit, postës elektronike dhe intranetit).

Burimet e organizatës do t'i përdor në mënyrë të përgjegjshme, duke marrë parasysh kritere të tilla si relevanca, efektiviteti, efikasiteti dhe qëndrueshmëria mjedisore.

Nuk do t'i përdor pajisjet e punës që ofron forumZFD-ja për aktivitete që shkelin ligjin ose Kodin e Sjelljes së forumZFD. Këtu përfshihen çdo lloj dhe të gjitha llojet e ngacmimit, frikësimit dhe degradimit, si dhe shikimi, ruajtja, procesimi, transmetimi dhe dyfishimi i dosjeve diskriminuese ose pornografike.

7. Dhënia dhe pranimi i dhuratave / Mashtrimi, korrupsioni dhe nepotizmi

Unë do t'i kontribuoj kulturës organizative të besimit dhe drejtësisë dhe në mënyrë aktive do ta kundërshtoj korrupsionin².

Prandaj, unë nuk do të përfshihem në asnjë formë të korrupsionit. Nuk do të ofroj, premtoj, jap ose pranoj asnjë mito, përfshirë dhurata apo favore të tjera në këmbim të përfitimeve personale ose profesionale.

² Korrupsioni përkufizohet këtu si "abuzimi i pushtetit që të është besuar për përfitime private" (Burimi: Transparency International <https://www.transparency.org/en/what-is-corruption>)

Në rastet kur dhënia dhe pranimi i dhuratave është praktikë standarde e vendit, do të sigurohem që dhuratat janë brenda kufijve të gjykimit të arsyeshëm dhe nuk e tejkalojnë shumën e €30. Në çdo rast tjetër do të kërkoj leje nga menaxheri i linjës, që është përgjegjës edhe për të vendosur nëse dhurata duhet t'i dorëzohet forumZFD-së.

Nuk do të shkëmbej oferta për punësim, punësim, mallra ose shërbime me seks apo favore seksuale, as me ndonjë formë tjetër të sjelljes poshtëruese, degraduese ose shfrytëzuese.

Do të përdor kujdesin e duhur dhe mënyrën transparente në angazhimin e stafit, blerjen e mallrave dhe dhënien e qasjes në shërbime.

Nuk do të përdor mashtrim, nepotizëm apo përvetësim për përfitime personale ose profesionale. Do të raportoj çdo dyshim për mashtrim, nepotizëm apo korrupsion përmes sistemit të brendshëm të raportimit që është krijuar, sikurse është përmendur.

8. Përdorimi i armëve

Në asnjë rrethanë nuk do të posedoj apo mbaj armë, eksplozivë apo municione.

Nuk do të përdor roje të armatosura nëse leja për ta bërë këtë nuk më është dhënë nga Anëtari i Bordit të Programeve dhe Kualifikimeve.

Do të sigurohem që nuk do të perceptohem në asnjë mënyrë si i identifikuar me ushtrinë apo forca të tjera të sigurisë.

Me dijeninë time, nuk do të përkrah asnjëherë aktivitete të dhunshme, qoftë direkt apo indirekt.

Do të përcjell Udhëzuesin për Siguri dhe Sigurim të forumZFD-së dhe Planin Lokal të Sigurisë në kuadër të kontekstit të punës sime.

9. Abuzimi me alkool, drogë dhe substanca ilegale

Nuk do të punoj nën ndikimin e substancave ilegale. Nuk do të drejtoj mjete nën ndikimin e alkoolit apo ndonjë droge tjetër. Posedimi, shpërndarja dhe konsumimi i substancave ilegale në vendin e punës apo gjatë punës është i ndaluar.

Raportimi i shkeljeve të Kodit të Sjelljes

forumZFD inkurajon stafin e vet që të raportojë çdo dyshim për shkelje të këtij Kodi të Sjelljes. Qëllimi i raportimit dhe përcjellja e shkeljeve të tjera të mundshme është që të mbrohen vlerat e parashtruara në Kodin e Sjelljes në mënyrë që të krijohet dhe të ruhet një i kuptuar i përbashkët i parimeve dhe kulturës organizative të forumZFD-së.

Raportimet për shkelje mund të bëhen përmes procedurave të brendshme të raportimit. Përshkrimi i hollësishëm i tyre gjendet në dokumentin në Shtojcë.

Referencat

- Deklarata e misionit të forumZFD-së
- Forumi i Shërbimit Civil Paqësor – Nenet e shoqatës
- Udhëzues: Përgjegjësia financiare, autoriteti nënshkrues, letra shoqëruese e mungesës (dokument i brendshëm)
- Politikat për Menaxhimin e Rrezikut të Sigurisë dhe Sigurimit (SSRMP) (dokument i brendshëm)
- Udhëzuesit për media sociale për punonjësit e forumZFD-së në Gjermani dhe vende të tjera (dokument i brendshëm)
- Kodi për punën në marrëdhëniet me publikun i Forum Ziviler Friedendienst e. E. (forumZFD) (dokument i brendshëm)
- Marrëveshja e punës: rregullorja për përfaqësimin e interesave të punonjësve në programet e forumZFD-së jashtë vendit (dokument i brendshëm)
- Procedura për ankesa nën Aktin e Përgjithshëm të Trajtimit të Barabartë – informacion për punonjësit (dokument i brendshëm)
- Raportimi i Brendshëm i Shkeljeve të Kodit të Sjelljes së forumZFD (dokumenti i brendshëm)